



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 60/8 prot.

Tiranë, më 17.07.2019

VENDIM
Nr.83, datë 17.07.2019

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 2, DATË 15.01.2019

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 2, datë 15.01.2019, “Për paralajmërimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Departamentit të Administratës Publike, për zbatimin e vendimit nr. 3694, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 4045, dt. 13.11.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për kthimin e nëpunësit civil *****”, në pozicionin e mëparshëm të punës”,

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet informacionit me nr. 1536 prot., datë 27.07.2017, nëpunësi ***** ka parashtruar përpara Komisionerit disa pretendime për parregullsi lidhur me dhënien e masës disiplinore, “Për largimin nga shërbimi civil dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, për punonjësin *****”, dhënëme Vendimin nr. 32, datë 27.7.2017, të Drejtorit të Shërbimeve të Brendshme, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Për të sqaruar rrethanat e rastit, Komisioneri, me urdhrin nr. 1536/1 prot., dt. 27.7.2017, ka nisur fillimin e verifikimit të këtij informacioni. Në përfundim të hetimit administrativ procesi është përmyllur me Vendimin nr. 186, datë 31.08.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit, të filluar me urdhrin nr. 1536/1 prot., datë 27.7.2017, të Komisionerit, “Për verifikimin e informacionit që përmban shkresa me nr. 1536 prot., dt. 27.7.2017, mbi mënyrën e realizimit të procedurës gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore”, për punonjësin *****”, në të cilin është vendosur:

“1. Të kërkoj nga Sekretari i Përgjithshëm, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, aktin administrativ nr. 5470 prot., datë 14.7.2017, “Mbi fillimin e procedimit disiplinor”, dhe të marrë masat që të anulohet çdo akt administrativ që ka dalë mbi bazën dhe në zbatim të tij.

*2. Të kërkoj nga Komisioni i Disiplinës që, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, vendimin nr. 27, datë 25.7.2017, për marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësën *****.*

*3. Të kërkojë nga Drejtori i Shërbimeve të Brendshme, të konstatojë menjëherë, si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, vendimin nr. 32, datë 27.7.2017, “Për largimin nga shërbimi civil dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, për punonjësën *****” dhe të rikthejë në detyrën e mëparshme punonjësën *****, duke i paguar pagën me të gjitha komponentët e saj, që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies financiare, deri në ekzekutimin e këtij vendimi”.*

Njëkohësisht, nëpunësi ***** i është drejtuar edhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e në përfundim të procesit gjyqësor, gjykata ka dalë me vendimin nr. 3694, datë 29.09.2017, me të cilin ka vendosur:

*“Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 27, datë 25.07.2017, të Komisionit të Disiplinës, me të cilin është vendosur largimi nga shërbimi civil, dhe kthimi i nëpunësit ***** në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e pagës për të gjithë periudhën nga momenti ndërprerjes së marrëdhënies financiare deri në rikthimin në vendin e mëparshëm të punës”.*

Ky vendim, mbi bazën e ankimit nga pala e paditur Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, e cila në përfundim të procesit gjyqësor ka dalë me vendimin nr. 4045, datë 13.11.2018, me të cilin ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 3694, datë 29.09.2017, duke e kthyer këtë të fundit në titull ekzekutiv, detyrimisht të zbatueshëm për palët në proces.

Në vijim, Komisioneri mbështetur dhe në zbatim të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2017”, me aktin nr. 658, datë 01.08.2018, ka filluar monitorimin e gjendjes së zbatimit të vendimeve gjyqësore, duke kërkuar informacion edhe nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nga informacioni i mbledhur është konstatuar moszbatimi nga ana e këtij institucioni të vendimit të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë nr. 3694, datë 29.09.2017, për rikthimin e gjyqfituesit ***** në një pozicion të rregullt të shërbimit civil. Ndërkohë, pozicioni i punës i gjyqfituesit rezultoi i zënë nga nëpunësi civil ***** , i cili kishte mbushur moshën për daljen në pension të plotë pleqërie.

Në përfundim të këtij procesi verifikimi, Komisioneri ka dalë me Vendimin paralajmërues nr. 2, datë 15.01.2019, “Për paralajmërimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Departamentit të Administratës Publike, për zbatimin e vendimit nr. 3694, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 4045, dt. 13.11.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për kthimin e nëpunësit civil ***** , në pozicionin e mëparshëm të punës”, në të cilin ka vendosur:

“1. Të kërkoj nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit për mbajtjen në marrëdhënie pune në pozicionin e shërbimit civil, “Specialist në Sektorin e Programeve të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Zhvillimit Rural”, në Drejtorinë e Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, të punonjësit ***** dhe ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës dhe asaj financiare.

2. Institucioni i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, pas përfundimit të procedurës së mësipërme, të dërgojë menjëherë në Departamentin e Administratës Publike, propozimin për plotësimin e pozicionit në fjalë, nga nëpunësi civil, ***** , sipas urdhërimit të vendimit gjyqësor.

3. Njësia Përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, në bazë të nenit 66/1, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe në zbatim të vendimit nr.3694, dt. 29.09.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 4045, dt. 13.11.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të emërojnë në pozicionin “Specialist në Sektorin e Programeve të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Zhvillimit Rural”, në Drejtorinë e Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, nëpunësin civil *****”.

Në zbatim të vendimit paralajmërues nr. 2, datë 15.01.2019, të Komisionerit, njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 358/1 Prot., datë 25.01.2019, i ka kërkuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. 3694, datë 29.09.2017, marrjen e masave dhe informimin për rregullimin e situatës së paligjshmërisë.

Njëkohësisht, institucioni i mbikëqyrur Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me shkresën nr. 581/4 Prot., datë 25.01.2019, ka informuar Komisionerin mbi veprimet e ndërmarra në kuadër të realizimit të detyrave të lëna në vendimin paralajmërues nr. 2, datë 15.01.2019, si më poshtë vijon:

“Në zbatim të vendimit nr. 2, datë 15.01.2019, të KMSHC-së, për ***** , është bërë ndërprerja e marrëdhënies së punës dhe asaj financiare” (materializuar me aktin shkresor nr. 581/1 Prot., datë 23.01.2019, “Njoftim për dalje në pension pleqërie”, (bashkëlidhur shkresës së dërguar).

“Përsa i përket sistemimit të ***** , në pozicionin “Specialist në Sektorin e Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, në Drejtorinë e

Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, iu informojmë se, ka filluar procedura e zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë”.

Në këtë kuadër, me qëllim zbatimin tërësor të vendimit paralajmërues nr. 2, datë 15.01.2019, Komisioneri me shkresën nr. 60/5 Prot., datë 13.05.2019, i ka kërkuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural informacion mbi ecurinë e zhvillimit të procedurës për sistemimin e nëpunësit *****, në pozicionin “*Specialist, në Sektorin e Programeve të Bujqësisë dhe Blegtorisë dhe Zhvillimit Rural*”.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me shkresën nr. 3947/1 Prot., datë 24.05.2019, ka përcjellë të gjithë praktikën shkresore në zbatim të vendimit gjyqësor nr. 3694, datë 29.09.2017, lënë në fuqi me vendimin gjyqësor nr. 4045, datë 13.11.2018, për rikthimin në punë të gjyqfituesit, *****.

Në analizë të praktikës shkresore të këtij rasti, vërej se:

Me Urdhrin nr. 493, datë 13.11.2018, të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është ngritur “*Komisioni i Posaçëm për shqyrtimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe ngritja e Sekretariatit Teknik*”. Komisioni i Posaçëm, në Proces-Verbalin me nr. 018/1 Prot., mbajtur në datë 18.01.2019, në përfundim të shqyrtimit administrativ për sistemimin në një pozicion të rregullt në shërbimin civil të nëpunësit *****, ka vendosur t’i parashtrijë mundësinë për t’u emëruar në pozicionin “*Specialist, në Sektorin e Programeve të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Zhvillimit Rural, në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural*”, me të njëjtën kategori III-b.

Përmes shkresës nr. 018/2 Prot., datë 21.01.2019, “*Propozim për pozicionim në punë*”, Komisioni i Posaçëm, ka njoftuar nëpunësin ***** për këtë propozim, i cili e ka pranuar pozicionin e ri të punës si “*Specialist, në Sektorin e Programeve të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Zhvillimit Rural, në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural*”, kategoria III-b, me përgjigjen e protokolluar me nr. 018/3 Prot., datë 24.01.2019, kthyer Kryetarit të Komisionit të Posaçëm.

Në vijim, pas pranimit të pozicionit nga nëpunësi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me shkresën nr. 018/4 Prot., datë 29.01.2019, “*Akt rekomandimi për sistemimin e nëpunësit ******”. Në përgjigje të kësaj shkrese, njësia përgjegjëse DAP, me Akt emërimin nr. 740/2 Prot., datë 07.02.2019, pas shqyrtimit të akt rekomandimit, në zbatim të vendimit gjyqësor të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me nr. 3694, datë 29.09.2017, lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit nr. 4045, datë 13.11.2018, ka emëruar *****, nëpunës civil në pozicionin “*Specialist, në Sektorin e Programeve të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Zhvillimit Rural, në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, në Drejtorinë e Përgjithshme të Programeve të Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*”,

kategoria III-b, akt të cilin ia ka përcjellë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me shkresën nr. 740/3 Prot., datë 07.02.2019.

Pas Akt emërimit nga njësia përgjegjëse DAP, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë ka nxjerrë aktin me nr. 1417/1 Prot., datë 11.02.2019, “Për emërimin në detyrë”, përmes së cilit ka vendosur:

“*****, emërohet nëpunës civil në pozicionin Specialist, në Sektorin e Programeve të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Zhvillimit Rural, në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, në Drejtorinë e Përgjithshme të Programeve të Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Marrëdhëniet financiare në këtë pozicion i fillojnë në datën 12.02.2019.

Kategoria e pagës III-b, grupi i diplomës 1 (14.000 lekë)”.

Për sa u parashtrua më sipër, arrij në përfundimin se nga ana e institucionit Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë zbatuar rekomandimet e lëna në Vendimin Nr. 2, datë 15.01.2019, “Për paralajmërimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Departamentit të Administratës Publike, për zbatimin e vendimit nr. 3694, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 4045, dt. 13.11.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për kthimin e nëpunësit civil ***** në pozicionin e mëparshëm të punës”, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 2, datë 15.01.2019, “Për paralajmërimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Departamentit të Administratës Publike, për zbatimin e vendimit nr. 3694, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 4045, dt. 13.11.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për kthimin e nëpunësit civil ***** në pozicionin e mëparshëm të punës”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit të inspektuar Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 2, datë 15.01.2019.

3. Për këtë vendim të njoftohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi *****.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha